



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 71, datë 17.03.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 67, DATË 14.07.2020, PËRSA I PËRKET  
NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE NGA PROGRAMI I  
RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; Urdhërit të zëvendëskryetarit të bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar; Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**


1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 67, datë 14.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese të grantit të rikonstruksionit të banesave:

- Z. Besim Tafa listuar në Aneksin 2, me numër rendor 12.

2. Miratimin e një shtese në Aneksin nr.1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 67, datë 14.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz”, duke kualifikuar si subjekt përfitues në programin e rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas tabelës së mëposhtme:

NR	NJËSIA ADM.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI I EKSPERTIZËS	SUBJEKTE PERFITUESE
215	MANËZ	BESIM	BAJRAM	TAFA	6	PRISHJE	PO

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.



Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani-Dyrmishi



**U shpall sot me datë 21.03.2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 201/prot.  
10

Durrës, më 29.03.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.71 datë 17.03.2023 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr 67 dt 14.07.2020, përsa i përket ndryshimit të listave emërore të familjeve nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz.”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**



